

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2463/1 datë 12.06.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3005/7 datë 21.07.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 5-të mbajtur më 21.07.2025, miratoi sa vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV KANAL FESTA SHPKNJ Kumanovë, për shkeljen e kryer të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 3 qershor 2025, nuk transmetoi së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, as nuk transmetoi së paku gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, në periudhën nga ora 7:00 deri në 19:00.

Shkelja e përmendur në paragrafin 1 të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2463/1, datë 12.06.2025, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJ Kumanovë, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e certifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit të dispozitave të Ligjit të cituar, lejet, certifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në përputhje me nenin 23, paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë - paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga leja dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 92, paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV, Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbim programor televiziv janë të detyruar gjatë ditës të transmetojnë së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuale maqedonase, ndërsa shërbimi publik transmetues së paku 40%. Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbim programor televiziv janë të detyruar të përmbushin së paku gjysmën e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni në periudhën nga ora 7:00 deri në ora 19:00.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 12 qershor 2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJ Kumanovë të transmetuar më 3 qershor 2025, në nivel lokal, nga ku është konstatuar se transmetuesi nuk ka transmetuar së paku 30% të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, as nuk ka transmetuar së paku gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, të transmetuar në periudhën nga ora 7:00 deri në ora 19:00.

Konkretisht, nga mbikëqyrja është konstatuar se më 3 qershor 2025, shërbimi programor televiziv i SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJ Kumanovë, ka transmetuar 4 orë 36 minuta dhe 58 sekonda të programit

të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që është 20.67% në total të programit të transmetuar gjatë ditës që përfshihet në llogaritjen për program të krijuar burimor (22 orë, 19 minuta dhe 48 sekonda). Minimumi ligjor prej 30% për transmetim të programit të krijuar burimor gjatë një dite, në raport me programin e transmetuar në total më 3 qershor që përfshihet në llogaritjen për program të krijuar burimor (22:19:48) është 6 orë 41 minuta dhe 56 sekonda. SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë ka transmetuar për 2 orë 4 minuta dhe 58 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Gjysma e minimumit ligjor (nga ora 06:41:56) është 3 orë 20 minuta dhe 58 sekonda të programi të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, sasia minimale që duhej të transmetohej në programin e SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, në periudhën nga ora 7:00 deri në ora 19:00. Gjatë kësaj periudhe, siç është konstatuar nga mbikëqyrja, janë transmetuar 48 minuta dhe 57 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që në këtë situatë është për 2 orë 32 minuta dhe 1 sekondë më pak se minimumi i kërkuar.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2463/1, datë 12.06.2025, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV KANAL FESTA DOOEL Kumanovës, më 13.06.2025, ka dërguar Shkresë ark.nr.10-2463/2 datë 13.06.2025, me të cilën ka dorëzuar dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2463/1 datë 12.06.2025, me qëllim që që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoj deklaram me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 16.06.2025. Brenda afatit të përcaktuar, SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 21.07.2025, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi se ndaj SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë duhet të shqiptohet masë - paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2463/1 datë 12.06.2025, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 5-të mbajtur më 21.07.2025, në përputhje me Konkluzionin ark.nr. 02-3005/7 datë 21.07.2025, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë dhe urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim përcaktimin nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në përputhje me nenin 24, paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2463/1, datë 12.06.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,**

Mr. Sasho STEFANOVSKI

Këshillë juridike: kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.